

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Vlorë më, 19. 11. 2020

## VENDIM

Nr. 52, datë 19. 11. 2020

### MBI

### NDRYSHIMIN E AFATEVE DHE MËNYRËS SË PAGESËS SË TARIFËS SË SHKOLLIMIT

Në mbështetje të nenit 49 pika 1 shkronja a, ë të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 25 pika 1 a, ë të Statutit të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë si dhe referuar propozimit të Administratorit të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë me shkresën Nr. 1787 prot datë, 03. 11. 2020, në mbledhjen e datës 19. 11. 2020 Bordi i Administrimit

### VENDOSI

1. Të miratojë propozimin e Administratorit për mënyrën dhe afatet e dorëzimit të pagesës së tarifës së shkollimit.
2. Për studentët që ndjekin ciklin e parë të studimeve për program të parë studimi pagesa e tarifës vjetore të kryhet brenda 60 ditëve nga data e fillimit të vitit akademik.
3. Për studentët që ndjekin ciklin e parë të studimeve për program të dytë studimi pagesa e tarifës vjetore të kryhet me dy këste të barabarta ku:
  - Kësti i parë të paguhet brenda 60 ditëve nga data e fillimit të vitit të ri akademik
  - Kësti i dytë të paguhet brenda 30 ditëve nga fillimi i semestrit të dytë.
4. Për ata studentë, të cilët ndjekin një program të dytë studimi në ciklin e parë të studimeve dhe që plotësojnë kriteret për përjashtim nga tarifa sipas akteve ligjore në fuqi, por kriteri përjashtues i tyre është program i dytë i studimit, pagesa e tarifës së studimit do të kryhet me këste të barabarta gjatë gjithë vitit akademik.
5. Për studentët që ndjekin një program të parë dhe të dytë studimi, në ciklin e dytë të studimeve, pagesa e tarifës së shkollimit, të kryhet e ndarë në katër këste:
  - Kësti i parë të paguhet brenda 30 ditëve nga fillimi i vitit akademik.
  - Kësti i dytë të paguhet para sezonit të provimeve të semestrit të parë.
  - Kësti i tretë të paguhet para sezonit të semestrit të dytë.
  - Kësti i katërt para diplomimit (për vitin e dytë) dhe brenda muajit shtator për vitin e parë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

6. Për ata studentë të cilët ndjekin një program të dytë studimi, në ciklin e dytë të studimeve dhe janë student ekselent, por nuk përfitojnë reduktim tarife në bazë të legjislacionit në fuqi, për kriterin përjashtues se është program i dytë studimi, pagesa e tarifës së studimit do të kryhet me kështë të barabarta gjatë gjithë vitit akademik.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve mbështetëse dhe Drejtoria e Ciklit të parë dhe të dytë të studimeve në UV.
8. Një kopje e këtij vendimi i bëhet me dije Administratori dhe Zv. Rektori Akademik.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Dr. Ervis MOÇKA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
ADMINISTRATOR**

Nr. ~~1287~~..... Prot.

Vlorë më, 03 . 11 .2020

Lënda: Propozim për ndryshime të afateve dhe mënyrës së pagesës së tarifës së shkollimit

**REKTORATIT  
REKTORIT  
PROF.DR.ROLAND ZISI**

**SENATIT AKADEMIK  
KRYETARIT  
PROF.DR.ROLAND ZISI**

**BORDIT TË ADMINISTRIMIT  
KRYETARIT  
DR.ERVIS MOCKA**

Në zbatim të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 52 "Funksionet e Administratorit" ;Statutit të Institucionit ; Udhëzimit nr.30 date 27.12.2011 "Për menaxhimin e Aktiveve në njësitë e Sektorit Publik";Vendimeve të Senatit Akademik nr 30 ,datë 27.06.2018 si dhe Vendimit nr 55 ,datë 06.09.2018 ;Vendimeve nr 13 ,datë 16.07.2018 të Bordit të Administrimit për ciklin e I-rë të studimeve si dhe Vendimit nr 22 ,datë 18.09.2020 ;

Më lejoni që me anë të kësaj shkrese , t'ju propozoj ndryshimet si më poshtë vijon në lidhje me kohën dhe mënyrën e pagesës së tarifës së shkollimit për ciklin e I-rë dhe të II-të të studimeve:

Propozimet për ndryshimet janë rrjedhojë :

1. Kushtet e pandemisë
2. Kërkesat e herëpashershme të studentëve për shtyrje afatesh pagesash dhe ndarje me këste të barabarta gjatë vitit akademik.

**Për ciklin e I-rë të studimeve propozoj :**



REPUBLIKA E SHQIPËRIË


**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
ADMINISTRATOR**

1. Tarifa vjetore e shkollimit për një program të parë të ciklit të parë të kryhet brenda 60 ditëve nga data e fillimit të vitit akademik.
2. Tarifa vjetore e shkollimit për një program të dytë të ciklit të parë të kryhet me dy këste të barabarta ku:
  - kësti i parë brenda 60 ditëve nga data e fillimit të vitit akademik
  - ndërsa kësti I dytë brenda 30 ditëve nga fillimi i semestrit të dytë
3. Për ata student të cilët ndjekin një program të dytë studimi në ciklin e parë të studimeve dhe që plotësojnë kriteret për përjashtim tarife sipas VKM –së ,por kriteri përjashtues I tyre është program i dytë i studimit ,propozoj pagesën me këste të barabarta gjatë gjithë vitit akademik.

**Për ciklin e II-të të studimeve propozoj :**

1. Për ata student të cilët ndjekin një program të parë dhe të dytë studimi në ciklin e dytë të studimeve ,propozoj pagesën me 4 (katër) këste të barabarta gjatë gjithë vitit akademik.
  - Kësti i I-rë brenda 30 ditëve nga fillimi i vitit akademik
  - Kësti i II-të para sezonit të semestrit të I-rë
  - Kësti i III-të para sezonit të semestrit të dytë
  - Kësti i IV –tërt para diplomimit (për vitin e dytë) dhe brenda muajit Shtator për vitin e I-rë.
2. Për ata student të cilët ndjekin një program të dytë studimi ,në ciklin e dytë të studimeve dhe janë student ekselent ,por nuk e përfitojnë reduktimin e tarifës sipas VKM-së ,për kriterin përjashtues se është program i dytë studimi ,propozoj pagesën me këste të barabarta gjatë gjithë vitit akademik.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin !



**ADMINISTRATOR  
MIRELA DUKA**